

# AKT THEMELIMI

## I SHOQERISE TREGTARE " BOA SORTE" SHPK

### Neni 1

Ne baze ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " si dhe te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit " me vullnetin tone te lire ne ortaket themelues te shoqerise kemi rene dakord te hartojme kete kontrate – akt themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k ) " **BOA SORTE** " **SHPK**, e cila do te veproje sipas legjislacionit ne fuqi e themeluar nga ortaket e saj si vijon:

**1. Z. Gjergji Puriqi** , i shtetesise shqiptare, i datelindjes 23.03.1978 , lindur ne Tirane , banues ne Tirane, identifikuar me numer personal H80323148N dhe Nr. Karte 034587284 Deklaron se sot me date **03.11.2020**, ka nenshkruar kete kontrate dhe ka rene dakort per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne baze te ketij akti themelimi duke respektuar kerkesat e legjislacionit shqiptare per shoqerite tregtare.

**2. Z. Rigers Hidri** , i shtetesise shqiptare, i datelindjes 06.02.1987 , lindur ne Tirane , banues ne Tirane, identifikuar me numer personal I70206011O dhe Nr. Karte 034428774 Deklaron se sot me date **03.11.2020**, ka nenshkruar kete kontrate dhe ka rene dakort per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne baze te ketij akti themelimi duke respektuar kerkesat e legjislacionit shqiptare per shoqerite tregtare.

### Neni 2


#### **EMERTIMI DHE FORMA E SHOQERISE**

Emertimi i shoqerise tregtare te themeluar nga ortaku i saj do te jete " **BOA SORTE**" **SHPK**. Forma e shoqerise tregtare e themeluar do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

### Neni 3

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te jete:



Tregtim materiale ndertimi dhe vegla pune, punime hidraulike, punime termozoluese, stampim fotografish, shtypshkrime te ndryshme, postera, reklama, stampime ne bluza, etj. tregtim material elektronike (kompjuter, fotokopje, printera, etj), punime ne fushen e ndertimit, prodhim dhe montim duralumini, punime elektrike, tregtim materialesh elektrike, punime druri dhe melamine dhe konstruksione metalike, sinjalistike rrugore, tregtim i artikujve te ndryshem ushqimor. Shoqeria per permbushjen e qellimeve te saj mund gjithashtu, si shembull por pa u kufizuar: Te bleje, shese, te marre me qira, te jape ose te marre hua ose me qira pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme; Te nenshkruaje marreveshje; Te marre hua, hipoteka dhe cdo gje tjeter qe konsiderohet te jete e nevojshme nga asambleja e pergjithshme. Tregtim material higjieno-sanitare. Tregtim dizinfektantesh. Tregtim inpute bujqesore. Tregtim material kancelarike. Tregtim bime dekorative. Tregtim materiale te ndryshme industriale me perdorim te gjere. Konsulence.

Tregti me shumice tonera, fikese zjarri dhe koalidim fikese zjarri. Mirembajtje, riparim te pajisjeve te teknologjise se informacionit, telekomunikacionit, radio nderlidhje, teknologjise se interkonjeksionit, paisje per rruajtje fizike, fotokopje, printera dhe servise te pajisjeve te mesiperme. Sherbime dhe tregtime te materialeve audiovizive, video telekonference.

Ne fushen e tregtimit me pakice dhe shumice, importi dhe eksporti te : veshmbathje, konfeksione, kostume sportive, hidrosanitare, hidraulike, elektrike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra dhe shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike, elektronike elektroshtepiake, fruta perime, artikuj industrial ushqimor dhe blegtoral, bime medicinale e etero vajore, pije te ndryshme alkoolike e freskuese, automjete te te gjitha llojeve, transport per vete dhe per te tjeret, prodhim dhe tregtim te materialeve duralumini, plastike dhe druri, dyer e dritare shkollore etj, pjese kembimi per makina e automjete, goma e bateri, pike servisi Rikonstruksione. Punime karpanierie. Punime dhe ndertime hidraulike dhe hidroteknike. Ndertime ujsjellesi, kanalizime, impinte vaditje, kanale, puse etj. Sistetem disifektimi te lokaleve Ambjente te mbyllur dhe te hapur, ,

Punime restaurimi, restaurimi i monumenteve te kultures dhe veprave te vecanta arkeologjike. Punime sherbimi, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe pyll; pastrim i siperfaqeve urbane, mirembajtje dhe zhillim i siperfaqeve urbane dhe dekorit – ndricime e sinjalizime Sherbime pastrimi te ndryshme te ambjenteve te brendshme dhe te jashteme. Tregtim i te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, automjeteve te te gjitha llojeve me zinxhire dhe goma. Tregtim i paisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit publik, industrial , kulturor, sportiv dhe bujqesor. Importim dhe eksportim te tyre. Tregtim vegla pune, vajra lubrifikante, paisje elektronike , kompjuter dhe aksesore. Tregtim te paisjeve dhe sistemeve te impianteve te ftohjes dhe ngrohjes, kondicionere, si dhe impiante te tjera te ndryshme te cdo lloji. Projektim instalim i paisjeve elektrike, industriale, elektro – shtepiake, sistemeve te ngrohje ftohjes, kondicionere etj.

Tregtim te paisjeve elektrike dhe elektronike te prodhimit, transmetimit, shperndarjes, kontrollit dhe matjes se energjise elektrike: transformatore, gjenerator, elektromotorr, matesa inteligjente, impiante te prodhimit dhe furnizimit me energji, sisteme automatike industriale dhe te ndricimit. Tregtim pjese kembimi, goma te llojeve te ndryshme, bateri etj Tregtim i karburanteve.

RH

Cauf

Neni 4  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria " BOA SORTE " SHPK do ta ketë seline saj në Tiranë me adresën Rrugen "Komuna e Parisit me numer pasurie 6/276+1-G4 rregjistruar me volum 19faqe 237Zon kadastrale 8260 , Tiranë,, dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ajo mund të krijojë ose të mbyllë në Shqipëri ose jashtë saj, filiale, përfaqësi apo seli të tjera.

Neni 5  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është në papercaktuar. Si ditë e fillimit të aktivitetit të saj do të merret data e rregjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë ta zgjasin këtë afat.

Neni 6  
**KAPITALI I THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i nëshkruar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) leke I ndarë në (2) kuota kapitali I shoqërisë nëshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zoterojnë 100% të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht

Z. Gjergji Puriqi I cili zoteron 50% (pesëdhjetë % të kapitalit)

Z. Rigërs Hidri cili zoteron 50% (pesëdhjetë % të kapitalit)

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Rigërs Hidri , i shtetësisë shqiptare, i datelindjes 06.02.1987 , lindur në Tiranë , banues në Tiranë, identifikuar me numer personal I702060110

Neni 7  
**KONTRIBUTET**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht



humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve.

Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

### Neni 8

#### **KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.


Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë.

Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo. Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.



### Neni 9

#### **MENYRA E FITIMIT DHE E KALIMIT TE KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

### Neni 10

#### **PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE**

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

### Neni 11

#### **SHPERNDARJA E FITIMEVE**

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

### Neni 12

#### **KUFIZIMET E SHPERNDARJEVE, CERTIFIKATA E AFTESIE PAGUESE**

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:



- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

### Neni 13

#### **PERGJEGJESITE PERSONALE PER SHPERNDARJET E NDALUARA**

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 77 të këtij ligji, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 77 të këtij ligji, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

### Neni 14

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

##### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- e) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- c) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

### Neni 15

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### Neni 16

### MENYRA E THIRRJES

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 17

### KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja



e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 18

#### **MARRJA E VENDIMEVE**

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### Neni 19

#### **ADMINISTRATORI**

##### **Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Rigers Hidri per një periudhe 5 vjeçare me te drejte rizgjedhjeje.

## NENI 20

### SHPERBLIMI ADMINISTRATORIT

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

## Neni 21

### PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

#### Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

#### Neni 22

### MOSMARREVESHJET

Per çdo mosmarreveshje ndermjet ortakeve, e lindur ne kuadrin ose per shkak te kesaj kontrate, do te behen te gjitha perpjekjet te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert çeshtja paraqitet Gjykares se Rrethit Gjyqsore Tirane, duke u gjykuar mbi bazen e ligjislacionit shqiptar.

#### Neni 23

### DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Per gjithçka qe nuk eshte shprehur ne aktin e themelimit te kesaj shoqerie do tu referohemi ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar dhe dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

Ky Akt – Themelimi u shkrua, lexua dhe u firmos me vullnet te lire e ndergjegje te plote nga ortaket e saj themelues te shoqerise “BOASORTE” SHPK sot me datën 03.11.2020, në pese kopje ne gjuhen shqipe.

#### ORTAKET E SHOQERISE

##### “ BOA SORTE ” SHPK

Z. Gjergji Puriqi



Z. Rigers Hidri

